



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.330/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër Imer Pantina, kandidat për kuvend komunal në Klinë nga subjekti politik Aleanca Kosva e Re (AKR), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Lokale të dates 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që subjekti politik Aleanca Kosva e Re (AKR), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se Imer Pantina kandidat për kuvend komunal në Klinë nga subjekti politik Aleanca Kosva e Re (AKR) gjat heshtjes zgjedhore me datën 21 dhe 22 tetor 2017 ka bërë fushatë duke shpërndarë foto në facebookun e tij, në të cilën bënë thirrje për ta votuar si kandidat për kuvend komunal. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik AKR thekson se publikimi i i fotografisë me llogon e numrit të partisë nga kandidati i tyre është bërë pa vetëdije dhe se nuk ka qene në dijeni se me kete veprim mud te thyhet heshtja zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndes në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet se si kandidati për kuvend komunal në Klinë nga nga subjekti politik Aleanca Kosva e Re (AKR), Imer Pantina gjatë heshtjes zgjedhore dhe gjatë ditës së votimit në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet ai dhe nr 34 i subjektit të tij politik, ku me këtë veprim ka shkelur Kodim e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Ndërsa lidhur me pretendimet e subjektit politik AKR se kandidati në fjalë nuk e ka ditur që postimi i bërë është shkelje e heshtjes zgjedhore, Paneli konstaton se këto pretendime nuk patën ndikim në meritat e lëndës pasi që në bazë të nenit 32 par 3 dhe 4 të LZP-së subjektet politike i informojnë anëtarët, mbështetësit e tyre dhe kandidatët rreth dispozitave të këtij kodi, dhe duhet të ndermarin të gjitha hapat e nevojshme për ti parandaluar nga shkelja e këtij kodi.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Aleanca Kosva e Re (AKR) është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL Anr.330/2017 më datën 23.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.